



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:227172
Datë: 21.05.2024
Numri i dokumentit: 05716095

A.nr. 2551/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni dhe me bashkëpunëtoren profesionale Donjeta Nikolla, në konfliktin administrativ të paditësit, M.N. me adresë në rrugën “... në ..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokati ... nga ...me adresë në ... kundër të paditurës, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me seli në Prishtinë me bazë juridike “anulim i vendimit”, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në prani të autorizuarit të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur, me datë 18.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. Refuzohet kërkesëpadia e paditësit, ... nga ..., me te cilin ka kërkuar që të anulohet vendimi Nr.2/K-2040 i datës 04.10.2022 i te paditurës, Komisionit për Ankesa të Nëpunësve Publik dhe Ankesa tjera të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, të vërtetohet si ligjshme grada akademike Bachelor Laborant i Mjekësisë që e ka fituar në Shqipëri, të vërtetohet se paditësi ka të drejtë të përdorë titullin e vet në vendin e tij të punës, të konstatohet se paditësit i takojnë të gjitha të drejtat dhe privilegjet që do ti kishin takuar sikur grada Bachelor ti ishte njohur në ditën kur e ka fituar, si e pabazuar.

II.Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative(më tutje LKA-së), në prani të autorizuarit të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur e ftuar me ftesë të rregullt (Provë: fletë kthesa e datës 19.03.2024).

I autorizuari i paditësit me padinë e datës 02.11.2022, në plotësimin e padisë së datës 18.01.2024 dhe në seancën mbi shqyrtimin kryesor të datës 18.04.2024 ka deklaruar që, mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, me të cilën është kërkuar që të anulohet vendimi përfundimtarë në procedurë administrative me numër 2/K-2040 i dt.04.10.2022 për faktin se konsideron se një vendim i tillë është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ 12/2023 për Procedurat e Njohjes së Diplomave dhe Gradave dhe Kualifikimeve të Shkollave të Larta Profesionale dhe Universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës. Më tutje shton se, paditësi ka paraqitur kërkesën për njohjen e diplomës në Qendrën Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (Naric) që t'ia njohë gradën Bachelor - Laborant i Mjekësisë të cilën paditësi e ka fituar pranë Universitetit Publik "Kristal" në Fakultetin e Shkencave Mjekësore në Tiranë - Republika e Shqipërisë. Shton se, siç është elaboruar në padi paditësi ka ofruar të gjitha dokumentet e novojshme të cilat dëshmojnë se ka fituar diplomën në këtë Universitet i cili në kohën sa paditësi i ka përfunduar studimet ka qenë i akredituar sipas ligjeve në fuqi të vendit, pra në Shqipëri dhe fakti se atij Universiteti i është hequr akreditimi, kjo nuk duhet të bëjë bazë që atij të mos i njihet kjo gradë shkencore. I njëjti ka kërkuar nga gjykata që vendimi i kontesuar të anulohet dhe ashtu siç është cekur në padi në bazë të provave të ofruara të vendosë në mënyrë meritore, duke i njohur paditësit gradën akademike bachelore-laborant i mjekësisë, si dhe të gjitha të drejtat tjera të cilat i janë mohuar paditësit me rastin e mosnjohjes së kësaj grade nga e paditura. I njëjti me padi ka kërkuar që në afat prej 15 ditësh, nën kërcënimin të përmbarrimit të dhunshëm, të detyrohet e paditura që ti paguajë paditësit shumën që do ta caktojë eksperti si kompensim për dëmet materiale dhe morale.

E paditura me përgjigjen në padi të datës 13.02.2024, si dhe me parashtresën e datës 11.04.2024, e konteston në tërësi padinë e paditësit si të pa bazuar, duke kërkuar nga gjykata që të refuzon në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar në ligj dhe të mbetet në fuqi Vendimi i të paditurës Nr.2/K-2040 i datës 04.10.2022 si i bazuar në ligj.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 18.04.2024, ka bërë administrimin e provave dhe atë: Diploma e dt.29.09.2012 për ... me numër të amzës KRNFEA004475; Vërtetimi i datës 03.11.2012 e vërtetuar me datën 10.02.2022; Leja për ushtrimin e profesionit e datës 30.06.2016; Përgjigja e datës 21.02.2022; Përgjigja e datës 24.01.2022 me numër të protokollit 683/3 e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e arkivave e Republikës së Shqipërisë; Verifikimi i dokumentit për njohjen e nënshkrimit e datës 31.01.2022 me numër 340; Vërtetimi i datës 14.06.2016; Kopja e letërnjoftimit e datës 08.06.2016; Vërtetimi i datës 28.02.2017; Kërkesa e dt.23.11.2021 me numër protokollit 5134; Vendimi i datës 04.10.2022 me numër 2-K-2040; Vendimi me numër Reference 0206-2846 i dt.01.07.2022; Email i datës 09.12.2022; Emaili i datës 03.06.2022 ora 13:15 i bashkangjitur dokumentit; Rekomandimi për mos

njohje i datës 07.06.2022; Shkresa e datës 14.06.2016 me numër protokolli 17/319 nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar, në përputhje me nenin 43 dhe 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, thënieve të padisë, përgjigjes-deklarimit të dhënë nga e paditura dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Me vendimin e datës 01.07.2022 me numër të Referencës 216-2846, paditësit i është refuzuar kërkesa për njohjen e gradës “Bachelor – Laborant Mjekësor” të fituar në Shkollën e Lartë Universitare Jo Publike “Universiteti Kristal” në Shqipëri.

I pakënaqur me këtë vendim paditësi ka paraqitur ankesë në Komisionin për Ankesa dhe Parashtrës në MASHT.

Me vendimin e të paditurës, me numër 2/1K-2040 të datës 04.10.2022 është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditësit numër 2040 e datës 08.08.2022, me arsyetimin se Divizioni për Njohje/Barasvlerë dhe Informim Akademik (NARIC) ka vendosur konform legjislacionit në fuqi, respektivisht Udhëzimit Administrativ 12/2018 të datës 10.09.2018 Parimi dhe Procedurat e Njohjes së Diplomave, Gradave dhe Kualifikimeve të Shkollave të Larta Profesionale dhe Universitare të Fituara jashtë Republikës së Kosovës.

I pa kënaqur me vendimin e të paditurës, paditësi ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datë 02.11.2022, duke e kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, gjykata iu referua Udhëzimit Administrativ 12/2018 për Parimin dhe Procedurat e Njohjes së Diplomave, Gradave dhe Kualifikimeve të Shkollave të Larta Profesionale dhe Universitare të Fituara jashtë Republikës së Kosovës, respektivisht nenit 3 paragrafi 2 i cili përcakton se: “Njohja/barasvlera e diplomave me qëllim të punësimit në Republikën e Kosovës, është kompetencë e Qendrës NARIC në MASHT”. Ndërsa neni 7 paragrafi 2 i kësaj Rregullore përcakton se: “Zyrtari përgjegjës mbledh informacione nga vendi ku është fituar diploma për verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së diplomës së dorëzuar për njohje, informata për akreditimin e institucionit dhe programit të studimit. Verifikimi i vërtetësisë së diplomave të fituara në vendet e regionit, bëhet përmes vulës apostile/legalizim”.

Bazuar në të lartcekurat gjykata gjeti se, e paditura pas pranimit të kërkesës së paditësit për njohje të gradës Bachelor – “Laborant Mjekësor” të fituar në Shkollën e Lartë Universitare Jo Publike “Universiteti

Kristal” në Shqipëri, NARIC Kosova me datë 21.02.2022 ka kontaktuar me Qendrën e Shërbimeve /Arsimore, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë së Shqipërisë për të Verifikuar Diplomën e paditësit , ku sipas NARIC-ut, është konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet për njohjen e gradës, pasi që QSHA në përgjigjen e dhënë me datë 03.06.2022 në ora 13:15, lidhur me verifikimin e diplomave të lëshuar nga Institucionet e Arsimit të Lartë të mbyllura në Republikën e Shqipërisë, theksoi se QSHA ka komunikuar institucionalisht me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave për Verifikimin e Regjistrave që janë depozituar në ambientet e kësaj të fundit. Institucioni i Arsimit të Lartë, ish Shkolla e Lartë Universitare Jo Publike “Universiteti Kristal”, ka qenë një Institucion i Arsimit të Lartë i pa akredituar dhe diplomat janë lëshuar në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi, andaj ato konsiderohen të pa vlefshme në Republikën e Shqipërisë.

Sipas pikës 3 të nenit 62 të Ligjit 9741 të datës 21.05.2007 për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë përcaktohet se: ” Çdo institucion i arsimit të lartë apo program studimi në arsimin e lartë publik dhe privat, përpara lëshimit të diplomave të para, i nënshtrohet procesit të akreditimit të parë. Akreditimi i parë i jep të drejtën një institucioni publik ose privat të arsimit të lartë të lëshojë diploma të njohura në Republikën e Shqipërisë”.

Gjykata nga shkresat e lëndës ka konstatuar se ish Shkolla e Lartë Universitare Jo Publike “Universiteti Kristal” ka qenë i licencuar me vendim numër 761 të datës 06.12.2005 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jo publike “Universiteti Kristal”. Ky Institucion nuk ka qenë i akredituar Institucionalisht. Me Vendimin Numër 539 të datës 06.08.2014, të Këshillit të Ministrave “Për heqjen e licencës disa institucioneve private të arsimit të lartë “ ka pushuar aktivitetin si institucion i arsimit të Lartë.

Gjykata konstaton se, në këtë rast duke qenë se Institucioni i Arsimit të Lartë, ish Shkolla e Lartë Universitare Jo Publike “Universiteti Kristal”, ka qenë një Institucion i Arsimit të Lartë i pa akredituar dhe diplomat janë lëshuar në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi, andaj ato konsiderohen të pa vlefshme në Republikën e Shqipërisë dhe si rezultat i kësaj njohja e këtyre diplomave nuk mund të bëhet as në Republikën e Kosovës, andaj paditësit i refuzohet padia si e pa bazuar.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e paditësit të dhëna në padi dhe të autorizuarit të paditësit në seancën mbi shqyrtimin kryesor i cili ka deklaruar se, “Universiteti i cili në kohën sa paditësi i ka përfunduar studimet ka qenë i akredituar sipas ligjeve në fuqi të vendit, pra në Shqipëri dhe fakti se atij Universiteti i është hequr akreditimi, kjo nuk duhet të bëjë bazë që atij të mos i njihet kjo gradë shkencore”, gjykata këto pretendime i refuzoi si të pa bazuara, nga arsyeja se diplomat në atë Universitet janë lëshuar në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi, andaj ato konsiderohen të pa vlefshme

dhe paditësit nuk i njihet kjo diplomë, si dhe paditësi pretendimet e tij nuk i ka provuar me fakte dhe prova të cilat kishin për të ndikuar që kjo gjykatë të mund të vërtetojë një tjetër gjendje faktike nga ajo që ka vërtetuar organi i paditur.

Prandaj, nga të lartë cekurat, gjykata në këtë çështje administrative vendimin e të paditurës e vlerëson si të drejtë dhe të ligjshëm, nuk ka të meta për shkak të cilave mund të anulohet, drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga e paditura, drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative, drejtë ka zbatuar ligjin material, kur ka hedhur poshtë si të pa lejuar ankesën e paditësit. Mbi këto arsye, gjykata kërkesëpadinë e paditësit nuk e aprovoi, sepse vlerësoi se nuk është zbatuar ligji në dëm të të njëjtit.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 64 të LKA-së, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr.2551/2022 data: 18.04.2024

Bashkëpunëtore Profesionale
Donjeta Nikolla

G j y q t a r e
Luljeta Maxhuni

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.